

Data __. __. 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: SHERBIM RIPARIM/MIREMBAJTJE FULL-RISK E PAJISJES MJEKESORE SKANER/SIEMENS SOMATOM SPIRIT 2S1 PER NEVOJAT E DREJTORISE SE SHERBIMIT SPITALOR SARANDE - MARRËVESHJE KUADËR ME NJË OPERATOR EKONOMIK - KU TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA ME AFAT 12 MUAJ

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50421000-2 - Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,497,600 (nje milion e katerqind e nentehjete e shtate mije e gjashtëqind) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Sarande** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

- i. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (nje) inxhinier për mirëmbajtjen e aparaturave objekt te këtij prokurimi me profil inxhinier biomjekësor/ elektronik/ elektrik/ mekatronik/ mekanik ose degë të tjera të ngjashme me to.

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për secilin nga stafi më sipër:

- CV-në e specialistit/ve;
- Çertifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre çertifikimeve lëshuar nga autoritetet të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,;
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.
- Listëpagesa ku të figurojnë emrat e inxhinierëve të deklaruar për periudhën **korrik 2023**.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

Shenim:

*Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.***

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- i. Një deklaratë që merr përsipër kryerjen e mirëmbajtjes të tipit Full Risk sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe specifikimeve teknike.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

- ii. Nje deklarate që merr përsipër zevendesimin e pjesëve te këmbimit dhe konsumit, që ato do jenë të reja dhe origjinale dhe ne përputhje me ato te përdorura fillimisht (te garantuara nepermjet certifikimit CE ose FDA) dhe që përfshihen në vlerën e kontratës dhe se garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera percaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

Në mbështetje të Nenit 17 të Ligjit nr.89/2014 “Për pajisjet mjeksore” si dhe të nenit 7 të ligjit 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014”, krahas kërkesës së miratimit/certifikimit CE, AK lejon edhe mundësinë e paraqitjes së certifikatës FDA, si një dokument, i cili konfirmon konformitetin e pajisjeve/artikujve mjekësore objekt prokurimi, me qëllim hartimin e kriterit në konformitet me dispozitat në fuqi, si dhe moskufizimin e OE, të cilët tregtojnë dhe paraqesin pajisje dhe artikuj mjekësore vetëm me certifikimin FDA dhe jo me certifikimin CE.

- iii. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga kompania Prodhuese e pajisjeve qe do te mirembaje ose nga Distributor të Autorizuar, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për këtë procedurë prokurimi për ofrimin e shërbimit të ofruar.

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 1 te nenit 77(*aftësia teknike*) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe me pikën 2 të nenit 41 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me qëllim për të njohur origjinën e pjesëve te kembimit dhe për të vërtetuar lidhjen e OE me prodhuesin ose distributorin e autorizuar dhe gjithashtu zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit (2020-2021-2022). Vlera mesatare e xhiros së duhet të jetë jo me pak se 40% te vlerës limit të lotit/loteve per te cilat ofertohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 42, 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2.2.2 Kopje të certifikuar / vërtetuara të bilanceve për tre vitet (2020-2021-2022) e fundit financiare që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kërkesa e mesipërme do të konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci të kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, sipas Aktit Normativ Nr.10, datë 26.03.2020 për një ndryshim në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci/blancet të kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pikë 3, e LPP, si dhe nenin 43, pikë 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
2. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41 pikë 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është

kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën **jo më të vogël se 40%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është ne përputhje me përcaktimet e RRPP nëni 41 pika 3:

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën **jo më të vogël se 40%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015/ose/ ekuivalent, objekti i së cilës t'i përkasë fushës së aktivitetit të OE. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike dhe me pikën 2 të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushte me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”.

2.3.2 Një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

2.3.3 Planin e veprimeve të mirëmbajtjes parandaluese që ofertuesi do të ndërmarrë, për secilin grup pajisjesh, ku të përcaktohen periodiciteti, procedurat operative dhe protokollat që do të përdorë përfshirë kalibrimet dhe testimet periodike të sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me standartet përkatëse evropiane.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, “*b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë*” si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “*Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.*”

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke**

argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :

Data: 11.09.2023 Ora: 10:00

Njesia e Prokurimit